



SHOQATA SHQIPTARE E O.R.L.



SHORL & KKQ E KOSOVËS



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

KONGRESI I XX MBARËKOMBËTAR I ORL DHE KIRURGISË KOKË-QAFË

LIBRI I ABSTRAKTEVE



ISBN 9789928363701



SHQIPTARËT E O.R.L.



SHORL & KKQ E KOSOVËS



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

KONGRESI I XX MBARËKOMBËTAR I ORL DHE KIRURGISË KOKË-QAFË

LIBRI I ABSTRAKTEVE

PRILL, 2024

KOMITETI SHKENCOR

DR.SH.M JETMIRA FEJZA

PROF. QAZIM HYSENAJ

PROF. DR. BIRKENA QIRJAZI

PROF. ASS. BESIM BOÇI

DR. DUGAGJIN SPANCA

COCHLEAR IMPLANTATION

Piotr H. Skarżyński

HiFocus SlimJ is a straight electrode of small diameter. Such electrode build facilitates preservation of functional hearing and inner ear structures during its insertion. Use of such electrode in combination with a minimally traumatic insertion method through the round window developed by H. Skarżyński, made it possible to extend the criteria of qualification for cochlear implant to patients with partial deafness, which means people with good, or slightly weakened hearing in low frequencies and significant hearing loss in high frequency range. Using the H. Skarżyński method, insertion of an electrode into a cochlea does not damage its normally functioning segments.

DIAGNOSIS AND TREATMENT OF MENIERE DISEASE

Cem Uzun¹, Emel Aslantaş²

¹ Koç University School of Medicine, Department of ORL, Istanbul, Türkiye

² Göztepe Prof. Dr. Süleyman Yalcin City Hospital, Department of ORL, Istanbul, Türkiye

cemuzun@yahoo.com, cemuzun@ku.edu.tr

Meniere disease's main symptoms are episodic vertigo lasting from 20 minutes to 24 hours, sensorineural type hearing loss that usually affects low frequencies, low-pitch tinnitus, and ear fullness. Usually the anamnesis is typical, most often at a single ear and the diagnosis can easily be made addition of audio-vestibular examination.

The first approach in the treatment is the medical treatment of acute attacks, followed by dietary restrictions and preventive treatment. If intractable vertigo insists, then several other approaches may be used ranging from less traumatic to more invasive ones, such as ventilation tube insertion, intratympanic steroid, meniett device, intratympanic gentamicin, sac surgery, labyrinthectomy, and vestibular neurectomy.

In this presentation, the authors will present some Meniere cases to describe the diagnosis and the treatment options of the Meniere disease.

DEVELOPMENTS IN HEARING SCIENCE: FROM BASIC ELECTROPHYSIOLOGY TO CELLULAR REGENERATION

Stavros Hatzopoulos PhD

Cochlear stress caused by:

- Aminoglycoside Antibiotics
- Antitumoral remedies (i.e. cocktail of drugs)
- Prolonged exposure to continuous / impulsive noise
- Prolonged exposure to noise AND industrial solvents
- Mechanical manipulations (i.e. during inner ear surgery)
- OR ANY Combination of those

generates functional alterations of the organ of Corti and subsequent Hearing Impairment; therefore, the ideas of Protection and Regeneration of the Inner ear have been greatly explored the last 20 years.

In terms of terminology:

PROTECTION: The idea of the mediated cochlear stress has promoted the hypothesis of using technologies and various media to timely block its generation.

REGENERATION: When the protection scheme is not applied on-time, THEN cochlear degeneration occurs. The idea of regeneration is to create the necessary circumstances where NEW ciliated cells can be formed. In theory the new cells SHOULD improve the functional status (i.e. hearing Threshold) of the Auditory system.

The Protection modalities are envisioned via a Systemic or Local delivery via Cochlear Implants. The Regeneration strategies follow two main pathways: (A) introduction of specific genes in target cells; and (B) Differentiation of stem cells.

TË DHËNA EPIDEMIOLOGJIKE PËR OTITET PURULENTE NË PERIUdhËN PRE- DHE POST-COVID-19 NË TRAJTIM SPITALOR NË QSUT

Prof. Dr. Birkena Qirjazi, Dr. Irini Ligu

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

Hyrje: Pandemia e Covid-19, numëron rastet e para në Evropë në fund të vitit 2019, por në fakt në Shqipëri rastet e para datojnë në mars 2020. Zyrtarisht kjo epidemi mbaroi në vitin 2023, por që nga viti 2021, pasi kaloi vala e parë më e rënduar në numra rastesh, spitalet dhe qendrat shëndetësore në Shqipëri, u bënë më të hapura dhe më të aksesueshme për popullatën pasi mbaroi dhe periudha e izolimeve apo kufizimeve të shprehura. Ndërkaq problemi tjetër me të cilin u përball sistemi shëndetësor në Shqipëri e më gjerë ishte periudha post-covid, si dhe prekja e moshës pediatrike.

Qëllimi i studimit: Të bëhet një panoramë statistikore të OMA dhe OM subacute të hospitalizuar në shërbimin ORL dhe dy shërbime pediatrike (infektiv dhe pediatri e përgjithshme) QSUT, pre- dhe post- pikut të pandemisë Covid-19, për të kuptuar ndikimin e izolimit dhe vetë epidemisë në sëmundshmëritë e tjera.

Metodologjia: Studimi është i tipit retrospektiv. Ai mori në analizë periudhën 2019-2020 dhe 2021-2022, pra një periudhë 4-vjeçare, ndarë në dy gjysma para dhe pas pikut të epidemisë. U shfrytëzuan të dhënat e SSIP dhe të dhënat e bllokut operator të Shërbimit ORL, QSUT me fjalët kyçe 'Otit media'. Nga të dhënat e mbledhura u përjashtuan rastet me kolesteatomë dhe otite media me perforacion të operuar me timpanoplastike. Rastet e filtruara ju nënshtruan analizës statistikore.

Rezultatet: 8 fëmijë dhe 40 të rritur numërohen të shtruar me diagnozën OM purulent akut e subakut për periudhën 2018-2019 me moshë mesatare përkatësisht 8.7 dhe 46.5 vjeç.

Për periudhën 2020-2021 numërohen 17 raste pediatrike me moshë mesatare 4 vjeç dhe 18 adulte me moshë mesatare 46.4 vjeç. Në krahasimin midis dy periudhave kohore, vihet re një ulje e numrit total të rasteve, por me rritje të rasteve pediatrike, kohëqendrimit spitalor për moshën pediatrike dhe tendencën për të kapur një grupmoshë më të vogël. Ndërkaq, analiza e të dhënave orienton për një databazë shumë të pasaktë dhe nevojën për të ndërtuar një sistem të dhënash me parametra më të sakta dhe të individualizuar.

Fjalë kyç: Covid-19, Otit media akut, Otit media subacute, epidemiologji, QSUT.

IMPLANTIMI I HERSHËM KOKLEAR: MAKSIMIZIMI I REZULTATEVE TË DËGJIMIT DHE TË FOLURIT PËRMES NDËRHYRJES NË KOHË DHE NDJEKJES AFATGJATË

Prof. Dr. Suela Sallavaci

Hyrje: Humbja e rëndë dhe e thellë e dëgjimit shoqërohet me një sërë efektsh të pafavorshme për individët e prekur, familjet e tyre dhe shoqërinë në tërësi. Zbulimi dhe ndërhyrja e hershme është thelbësore për të ruajtur dëgjimin dhe funksionet përkatëse. Implantet kokleare (CI) janë dëshmuar efektive në këtë drejtim. Ky studim ka për qëllim të vlerësojë ndikimin e CI tek fëmijët përsa i përket aftësive gjuhësore.

Metoda: Popullata e studimit përfshinte 35 pacientë, 32 fëmijë dhe 3 të rritur (të cilët i kemi trajtuar që në fëmijëri, ndaj e pamë të arsyeshme t'u jepnim mundësinë për të vendosur implante. Dy nga të rriturit humbën dëgjimin në mënyrë progresive gjatë jetës së tyre), (mosha mesatare 8.4 vjeç) u diagnostikua me humbje të thellë të dëgjimit dhe ku aparatet e dëgjimit nuk e përmirësonin situatën. Këta pacientë iu nënshtruan CI. Është mbledhur baza socio-demografike. Aftësitë gjuhësore u vlerësuan para dhe pas CI, dhe rezultatet u krahasuan duke përdorur testin McNemar për të dhënat e çiftuara. Testi Chi-square u përdor për krahasime të tjera.

Rezultatet: Shumica e pacientëve të implantuar ishin meshkuj (63.6%). Nga ekzaminimet e kaluara, nuk kemi parë asnjë provë që vërteton një mbizotërim më të lartë të humbjes së dëgjimit tek meshkujt ndaj femrave; prandaj, shkalla më e lartë e implantimit tek fëmijët meshkuj është e rastësishme dhe nuk tregon një tendencë. Para implantimit vetëm 33.3% e rasteve përdornin aparate dëgjimi dhe terapi të të folurit, dhe 71% e tyre nuk kishin fare aftësi gjuhësore. Megjithatë, 97% e rasteve kishin të paktën pak perceptim të stimulit akustik. Pas CI 87.9% e rasteve iu nënshtruan terapisë së të folurit. CI rriti ndjeshëm përqindjen e fëmijëve me të paktën aftësi gjuhësore të kënaqshme (nga 6.5% në 51.6%; $P < 0.001$). Pas implantimit, kombinimi i aparateve të dëgjimit dhe terapisë së të folurit rriti ndjeshëm përqindjen e fëmijëve me të paktën aftësi gjuhësore të kënaqshme (nga 31.8% në 81.8%; $P = 0.025$). Përdorimi i aparateve të dëgjimit në veshin tjetër rrit ndjeshëm përqindjen e shfaqjes së aftësive gjuhësore të paktën të kënaqshme pas implantimit (nga 28.6% në 83.3%; $P = 0.010$).

Përfundime: Implantimi koklear është efektiv për përmirësimin e aftësive gjuhësore tek fëmijët e prekur nga humbja e rëndë dhe e thellë e dëgjimit në Shqipëri, veçanërisht kur shoqërohet me përdorimin e aparateve të dëgjimit në veshin tjetër dhe terapinë e të folurit.

Fjalë kyçe: Shqipëri, implant koklear, aparate dëgjimi, humbje dëgjimi, fëmijë, logopedi.

COMPUTERIZED TOMOGRAPHY AS A DIAGNOSTIC TOOL IN RHINOLOGY

Ljiljana Jovancevic^{1,2}

¹ University of Novi Sad, Faculty of Medicine, Novi Sad, Serbia.

² University Clinical Centre of Vojvodina, Clinic for Otorhinolaryngology and Head and Neck surgery, Novi Sad, Serbia.

ljiljana.jovancevic@mf.uns.ac.rs

The structure of a person's paranasal sinuses is as unique as a set of fingerprints, so contemporary Rhinology uses both computerized tomography (CT) and magnetic resonance (MR) as diagnostic imaging tools. CT is superior to MRI in demonstrating bony anatomy, osseous margins, the extent and localization of inflammatory lesions and complications. CT has major limitations in the differentiation of soft tissue masses (for that indication, MRI is superior to CT). CT of the nose and paranasal sinuses should not be used as first, nor as only diagnostic procedure, and should always be interpreted in accordance with symptoms, clinical and nasal endoscopy finding. The timing of CT scanning, positioning of the patient's head, the use of suitable CT-scan window, native scan or done with intravenous contrast media, analysis of all 3 projections, knowledge of how is the direct scanning done, proper looking at and analyzing bony changes and mucosal thickenings, are just some of the very important issues that need to be kept in mind when analyzing CT scans. The radiation dose can be quite high, so indications for CT should always be reconsidered. Nasal endoscopy must be done prior to CT scanning. MR should be added and radiologist consulted, whenever in any doubt of correct diagnosis.

KIRURGJIA ENDOSKOPIKE NAZO-SINUSALE NISUR NGA DISA RASTE KLINIKE

Alfred Aga MD, Guardmond Ajasllari MD, Armida Kosta MD

Kirurgjia endoskopike nazo-sinusale është një ndërhyrje kirurgjikale që përdor një endoskop për të parë dhe operuar kavitetet nazale, sinuset paranazale si dhe bazën kraniale. Kjo teknikë lejon kirurgët të kenë qasje të saktë dhe precize në zonat te prekura nga sëmundjet, duke zvogëluar dëmtimet e indeve përreth dhe duke përmirësuar rezultatet klinike. Procedura kryhet nën anestezinë e përgjithshme dhe mund të zgjasë vetëm disa orë.

Një avantazh kyç i kirurgjisë endoskopike është aftësia e saj për të trajtuar një gamë të gjerë patologjish, duke përfshirë polipet nazale, sinuzitin kronik, devijimin e septumit nazal dhe patologjitë e tjera sinusale duke përfshirë tumore beninje edhe malinje. Po ashtu, kirurgjia endoskopike preferohet për invazivitetin e saj të ulët në krahasim me kirurgjinë tradicionale, të cilat kërkojnë qasje nga jashtë duke u shoqëruar me një rrezik më të lartë të komplikacioneve post-operatore. Gjithashtu i ofron pacientëve një rikuperim më të shpejtë krahasuar me kirurgjinë tradicionale, me kohë të shkurtuar qëndrimi në spital dhe me një përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë së jetës.

Përfundimi: Si përfundim, kirurgjia endoskopike e sinuseve paranazale ofron avantazhe të shumta krahasuar me kirurgjinë tradicionale me qasje nga jashtë. Falë invazivitetit të ulët, efikasiteti të lartë dhe kohës më të shkurtër të rikuperimit, kjo procedurë konsiderohet si një trajtim efikas dhe i sigurt për një shumëllojshmëri patologjish të sinuseve paranazale dhe jo vetëm, duke përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve dhe zvogëluar rrezikun e komplikacioneve post-operatore.

DOS AND DON'TS IN RHINOPLASTY

Süreyya Şeneldir MD

Rhinoplasty, a surgical procedure aimed at reshaping the nose for aesthetic or functional purposes, remains one of the most commonly performed plastic surgery interventions worldwide. With the increasing demand for rhinoplasty and advancements in surgical techniques, it is imperative to establish evidence-based guidelines regarding preoperative, intraoperative, and postoperative practices to optimize patient outcomes and minimize the risk of complications. This review synthesizes current literature and expert opinions to provide comprehensive recommendations on the dos and don'ts in rhinoplasty. Key considerations include the importance of patient education and realistic goal-setting, thorough preoperative assessment and counseling, effective communication between patients and surgeons, adherence to preoperative and postoperative care protocols, and prudent management of intraoperative challenges. Additionally, the significance of patient selection, surgical planning, and postoperative monitoring is underscored to ensure patient safety and satisfaction.

Purpose of study

Through a systematic evaluation of dos and don'ts in rhinoplasty, this study aims to serve as a valuable resource for both patients and healthcare providers, facilitating informed decision-making, optimizing surgical outcomes, and enhancing the overall quality of care in rhinoplasty practice.

References:

1. Gruber, R. P., Nahai, F., & Bogdan, M. A. (Eds.). (2019). *Rhinoplasty: The Experts' Reference* (2nd ed.). Thieme.
2. Guyuron, B. (2020). *Rhinoplasty: Expert Consult Premium Edition: Enhanced Online Features and Print* (4th ed.). Elsevier.
3. Kridel, R. W., & Konior, R. J. (Eds.). (2019). *Dallas Rhinoplasty: Nasal Surgery by the Masters* (4th ed.). CRC Press.
4. Sabri, A., Murshed, F. A., & Zakaria, O. (2019). Rhinoplasty: Do's and Don'ts. *Egyptian Journal of Otolaryngology*, 35(4), 457-461.

TRAJTIMI I PJESËS SË MESME TË HUNDËS SË SHTREMBËR

D.Sh.M Jetmira Fejza

Hyrje: Hunda e shtrembër (e devijuar) është një nga sfidat më të mëdha në rinoplastikë. Shumë teknika dhe përjasje janë bërë në këtë drejtim për një rezultat sa më natural dhe funksional.

Qëllimi: Të tregojmë metodat e ndryshme për korrigjimin e hundës së devijuar dhe përdorimin e tyre sipas deformimit.

Materiali dhe metoda: Studim retrospektiv ku janë studiuar rastet e operuara gjatë 2020-2024.

Rezultatet: Spreader graftet janë graftet më të përdorura për të korrigjuar deformimet e pjesës kërcore të hundës.

Diskutime: Graftet për drejtimin e hundës së devijuar janë përdorur në gjithë qendrat e referencës në botë, por kohët e fundit disa metoda të reja janë duke bërë risi, si: Ansa banner etj.

OSTEOTOMITË NË HUNDËN E SHTREMBËR

Dr. Roven Sinani

Hunda e shtrembër është e shpeshtë në praktikën kirurgjikale të mjekut rinolog. Mund të jetë e lindur, ose e fituar si pasojë e traumave apo kirurgjive të mëparshme. Zgjidhja është komplekse dhe kërkohen shumë procedura kirurgjikale. Një prej ketyrë procedurave është osteotomia. Ato janë të llojeve të ndryshme në varësi të rastit. Rëndësia e tyre është e madhe në rezultatin funksional dhe atë estetik.

Në këtë punim do të pasqyrojmë llojet e osteotomive, si ajo perkutane apo e brendshme, apo edhe piezo. Gjithashtu të rëndësishme janë edhe double-osteotomitë në hundët e shtrembëra.

APPROACH TO DEVIATED TIP

Süreyya Şeneldir MD

Introduction: Deviation of the nasal tip represents a common challenge encountered in rhinoplasty surgery, influencing both functional and aesthetic outcomes. Various surgical techniques have been developed to address this issue, yet there remains a lack of consensus regarding the optimal approach. This study aims to provide a comprehensive review of the approaches to deviated nasal tips, including their indications, techniques, outcomes, and potential complications.

Methods: A systematic review of the literature was conducted, utilizing electronic. Inclusion criteria encompassed original research articles, review papers, and clinical studies published in English, focusing on surgical approaches to correct deviated nasal tips.

Results: The review identified various surgical approaches to correct deviated nasal tips, including open rhinoplasty, closed rhinoplasty, and hybrid techniques. Each approach offers distinct advantages and limitations, depending on the severity and etiology of the deviation. Commonly utilized techniques include cartilage repositioning, suture techniques, and tip grafting. Outcome measures typically include improvement in nasal tip symmetry, nasal airflow, patient satisfaction, and complication rates.

Conclusion: Correcting a deviated nasal tip represents a challenging aspect of rhinoplasty surgery, requiring careful consideration of various surgical approaches. A thorough understanding of the anatomical principles, patient evaluation, and surgical techniques is essential for achieving favorable outcomes while minimizing complications. This review serves to elucidate the current approaches to deviated nasal tips, guiding clinicians in selecting the most appropriate strategy for each patient.

Keywords: *Rhinoplasty, nasal tip, nasal deviation, surgical techniques, clinical recommendations, systematic review.*

References:

1. Romo, Thomas, et al. "Management of the deviated nose: a simplified, systematic, and algorithmic approach." *Aesthetic Surgery Journal* 39.4 (2019): 349-364.
2. Tas, Süleyman, et al. "The effectiveness of modified lateral crural overlay technique on nasal tip projection and rotation in rhinoplasty." *Journal of Craniofacial Surgery* 30.7 (2019): 2040-2044.
3. Mocan, Gürkan, et al. "Effectiveness of different septoplasty techniques on nasal function and airflow: A comparative study." *Auris Nasus Larynx* 46.6 (2019): 875-881.

KIRURGJIA RIKONSTRUKTIVE NË REGJIONIN KOKË-QAFË; QAFË; EKSPERIENCA E DY VITEVE TË FUNDIT

Alfred Aga MD, Guarmdond Ajasllari MD, Armida Kosta MD

Kirurgjia mini invazive është gjithnjë më e përdorur në fushën e kirurgjisë së kokë-qafës. Kjo teknikë ofron avantazhe të shumta në krahasim me atë tradicionale.

Kirurgjia mini invazive në fushën e kokë-qafës është pjesë e procedurave kirurgjikale të kryera përmes prerjeve të vogla duke përdorur mjete të specializuara si endoskopë dhe mikroskopë. Kjo teknikë lejon kirurgët të kenë qasje në zona të vështira me precizion të lartë duke shmangur dëmtimet e indeve përreth.

Një avantazh i rëndësishëm i kirurgjisë mini invazive është rreziku minimal i dëmtimit të strukturave vitale. Tjetër avantazh i rëndësishëm është koha e shkurtër e rikuperimit. Meqënëse prerjet janë të vogla dhe trauma e indeve përreth është minimale, pacientët kanë tendencë të rikuperohen më shpejt krahasuar me kirurgjinë tradicionale. Kjo rezulton në qëndrim më të shkurtër në spital dhe kosto më të ulët për sistemin shëndetësor.

Gjithashtu, kirurgjia mini invazive mund të çojë në rezultate estetike më të mira krahasuar me kirurgjinë tradicionale. Falë prerje të vogla në zona jo të dukshme, pacientët mund të përfitojnë një pamje sa më natyrale pas operacionit.

Mikrokirurgjia është shumë e rëndësishme në regjionin e kokë-qafës, veçanërisht për vendosjen e flap-ave të lirë pas një kirurgjie demolitive.

Përfundimi: Në përfundim, kirurgjia mini invazive në rajonin kokë-qafë ofron avantazhe të shumta në krahasim me kirurgjinë tradicionale, duke përfshirë rreziqe dhe komplikacione më të ulëta, kohë më të shkurtër të rikuperimit dhe rezultate estetike më të mira. Kjo teknikë kirurgjikale është gjithnjë e më e përhapur dhe paraqet një zhvillim të rëndësishëm në fushën e kirurgjisë së kokë-qafë.

MENAXHIMI KIRURGJIKAL I FISTULËS SË PLEKSIT TË PARË BRANKIAL TIP II, PAS KATËR DIAGNOSTIKIMEVE TË GABUARA DHE TRE NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PASUKSESSHME. RAPORTIM RASTI.

Besim Boçi, Klaudia Stajka

Qëllimi i këtij rast raporti është përshkrimi i trajtimit të suksesshëm kirurgjikal të një fistule të pleksit të parë brankial tip II, pas katër diagnostikimeve të gabuara dhe tre ndërhyrjeve kirurgjikale me rezultat të pakënaqshëm.

Një vajzë 11-vjeçare u paraqit në klinikën tonë me një histori të përsëritur të enjtjes së qafës dhe sekrecione mukopurulente nën këndin e majtë mandibular dhe në kanalën e jashtëm të dëgjimit. Kemi arritur heqjen e plotë kirurgjikale të traktit fistuloz me qasjen e parotidektomisë sipërfaqësore dhe me ruajtjen e plotë të nervit facial. Ekzaminimi histopatologjik konfirmoi diagnozën e fistulës së pleksit të parë brankial, tip II. Trajektorja e fistulës u paraqit e alternuar për shkak të operacioneve të mëparshme joadekuate. Ne përdorëm një kateter Tiemann për të identifikuar dhe ndjekur traktin fistuloz. Me sukses disekuam deri në murin e përparmë të kanalit të jashtëm të dëgjimit (KJD), ku përfundonte fistula. Fundi i taktit u ligua me sutura.

Ne mendojmë se kjo teknikë mund të lehtësojë diseksionin e plotë të fistulës së përsëritur dhe/ose të keqtrajtuar, me plane kirurgjikale të alternuara, në raporte të ngushta me nervin facial, me rrezik minimal dëmtimi. Periudha e ndjekjes postoperatore ishte 12 muaj; ekzaminimi klinik dhe gjetjet në RM nuk treguan shenja recidive.

Fjalë kyç: *Fistula, pleksi i parë brankial, nervi facial, kateteri Tiemann, trajtim kirurgjikal.*

Referencat:

1. Al-Mahdi AH, Al-Khurri LE, Atto GZ, Dhaher A. Type II first branchial cleft anomaly. J Craniofac Surg. 2013;24(5):1832-5.
2. Castellana G, Falcioni M, Di Lella F First Branchial Cleft Sinus. 2021;50(6):52-53.
3. Souza AR, Uppal HS, Zeitoun RD (2002) Updating concepts of first branchial cleft defects: a literature review. Int J Pediatr Otorhinolaryngol 62:103-109.
4. Liu H, Cheng A, Ward BB, Wang C, Han Z, Feng Z. Clinical Manifestations, Diagnosis, and Management of First Branchial Cleft Fistula/Sinus: A Case Series and Literature Review. (2020) Journal of oral and maxillofacial surgery : official journal of the American Association of Oral and Maxillofacial Surgeons. 78 (5): 749-761.
5. Chen MF, Ueng SH, Jung SM, et al Type II first branchial cleft cyst masquerading as an infected parotid Warthin's tumor. Chang Gung Med J 2006;29:435Y439.

LARINGEKTOMITË TOTALE PAS KEMIORADIOTERAPISË

Ass. Dr. Zgjim Limani, Ass. Dr. Etnik Bajraktari, Dr. Refki Krasniqi, Dr. Arsim Elezaj, Dr. Arbnora Shaqiri, Prof. Dr. Qazim Hysenaj

Hyrje: Numri i pacientëve që kanë nevojë për trajtim me kirurgji të laringut pas kemioradioterapisë është në rritje si pasojë e avancimeve dhe rezultateve mjaft të mira në trajtimin e tumoreve malinje të laringut, në stadiet e hershme, me radioterapi. Nevoja për trajtim kirurgjik lind tek rastet ku kemi perzistim ose recidivë të procesit primar dhe si të tillë duhet të kemi parasysh specifikat dhe problematikat që shfaqen tek këta pacientë. Komplikimet postoperative janë dukshëm më të shprehura në këto raste si pasojë e kompromentimit të vaskularizimit të zonës së rrezatuar.

Qëllimi: Prezantimi i trajtimit kirurgjik të karcinomës skuamoqelizore të laringut pas kemioradioterapisë në Klinikën e ORL-së në QKUK.

Materialet dhe metodat: Prezantim rasti dhe rishikim i literaturës.

Pacienti mashkull, 55 vjeç, i trajtuar me kemioradioterapi si modalitet primar para 1 viti, shfaqet me pengesa në frymëmarrje dhe masë tumorale në regjionin glotik të laringut. Pacienti i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale – laringektomi totale me rekonstruim me flap lokal (pectoralis major myocutaneous flap). Po ashtu kemi rishikuar raste të ngjashme të publikuara në literaturë në gjuhën angleze, përparësitë dhe komplikimet në përdorimin e metodave të ndryshme në plastikimin e defektit post-operativ si dhe procesin e gëlltitjes.

Konkluzion: Laringektomia pas kemioradioterapisë ndërlidhet me shkallë të lartë të komplikimeve perioperative dhe morbiditet të lartë, kryesisht si pasojë e fistulave faringo-kutane që ndërlidhen me pengesa të shkallëve të ndryshme në gëlltitje si dhe hospitalizim të zgjatura. Përdorimi i flapeve regjionale dhe të largëta, që kanë vaskularizim të pakompromentuar si pasojë e rrezatimit duhet të konsiderohen pasi që edhe sipas përvojës sonë dhe asaj në literaturë ulin ndjeshëm shkallën e komplikimeve post-operative. Përzgjedhja e flapeve dhe përbërjes së tyre duhet bërë duke marrë parasysh planifikimin për trajtim të mëtejshëm dhe resurseve që posedon institucioni shëndetësor.

Referencat:

1. Sievert M, Goncalves M, Binder B, Mueller SK, Rupp R, Koch M, Dürr S, Traxdorf M, Hecht M, Iro H, Gostian AO. Salvage laryngectomy after primary radio- and radiochemotherapy : A retrospective study. HNO. 2021 Aug;69(Suppl 2):47-52. doi: 10.1007/s00106-021-01030-3. Epub 2021 May 21. PMID: 34019140; PMCID: PMC8397647.
2. Silverman DA, Puram SV, Rocco JW, Old MO, Kang SY. Salvage laryngectomy following organ-preservation therapy - An evidence-based review. Oral Oncol. 2019 Jan;88:137-144. doi: 10.1016/j.oraloncology.2018.11.022. Epub 2018 Nov 29. PMID: 30616784.
3. Bathula SS, Stern NA, Ross A, Patrick T, Talatala ER. Role of Pectoralis Major Myocutaneous Flap in Laryngectomy Surgery: Single Surgeon Experience. Cureus. 2021 Sep 22;13(9):e18198. doi: 10.7759/cureus.18198. PMID: 34722018; PMCID: PMC8544620.

REHABILITIMI VOKAL PAS LARINGEKTOMISË TOTALE

Dr. Albana Çuko¹, Prof. Asoc. Besim Boçi²

¹ Mjeke ORL, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

² Shef i Departamentit OrL-Okulistike, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

Hyrje: Kanceri i regjionit kokë-qafe dhe trajtimet e menaxhimi mjekësor i tij, shpesh kanë pasoja afatgjata negative në strukturat dhe indet e përfshira në gëlltitje dhe prodhimin e të folurit. Pas laringektomisë si një nga trajtimet kryesore në Kancerin e laringut në stade të avancuara pacienti do të ndryshojë mënyrën e të folurit përmes neoglottisit me anë të rehabilitimit primar dhe sekondar vokal.

Qëllimi: Vlerësimi i shpeshëtësisë së rehabilitimit primar dhe sekondar vokal në pacientët që i nënshtrohen laringektomisë totale, vlerësimi i ditë mbajtjes së protezës, arsytet e ndërrimit të protezës në Shërbimin ORL në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Metoda: Studimi i mëposhtëm është një studim seri rastesh që përfshin periudhën kohore maj 2008 deri në korrik 2018 në Shërbimin ORL, QSUT. Janë futur në studim 165 pacientë; nga mosha 35 vjeç deri në 81 vjeç; 89.6 % rezultuan me karcinomë laringsi dhe 17 pacientë rezultuan me karcinomë laringofaringeale (10.4%). Lloji i kirurgjisë që është zgjedhur për pacientët e marrë në studim është laringektomia totale në pacientët me kancer të laringut dhe laringektomi totale me rezekcion të faringut për pacientët me kancer të laringofaringut. Rehabilitimi vokal në pacientët e marrë në studim është realizuar me protezat Provox 1 dhe 2. Për çdo zëvendësim të protezave janë ruajtur të dhënat mbi indikacionet e zëvendësimit të protezave, problemet teknike, madhësia e protezave, problemet e lidhura me fistulat, trajtimi mjekësor.

Konkluzione: Nga studimi vihet re se nga përdorimi i protezave të zërit Provox mund të arrihet një sukses i lartë i rehabilitimit vokal në pacientët që i nënshtrohen LE në Shërbimin ORL. Krahasuar me vende të tjera ditëmbajtja mesatare e protezës së zërit është shumë më e lartë. Mendojmë se kjo ditëmbajtje e lartë e protezës mund të lidhet me dietën ushqimore që këta pacientë ndjekin pas vendosjes së protezës si ushqimet pikante, turshitë, piperi, hudhra dhe mos konsumimi i birrës. Gjithashtu konsumimi i pijes tradicionale shqiptare “raki” mendohet se ka një rol në rritjen e ditëmbajtjes së protezës.

Fjalët kyçe: kanceri i laringut, proteza e zërit, rehabilitimi primar, rehabilitimi sekondar, ditë mbajtja e protezës, numri i protezës, lloji i protezës.

TUMORET E GJENDRËS PAROTIS, STADI I SËMUNDJES NË MOMENTIN E DIAGNOSTIKIMIT, PROCEDURAT DIAGNOSTIKE DHE FOLLOW-UP TERAPEUTIK. KRAHASIMI ITALI-SHQIPËRI.

**D.Sh.M Xhevair Hoxhallari, Dr. Gilberto Acquaviva,
Dr. Ervin Dyrmishi**

¹ Shërbimi i Otorinolaringologjisë dhe Kirurgjisë Kokë-Qafë, Spitali Universitar Nënë Tereza, Tiranë, Shqipëri;

² Departamenti i Otolaringologjisë, Spitali San Camillo Forlanini, Romë, Itali;

³ Departamenti i Otolaringologjisë, Spitali San Filippo Neri, Romë, Itali;

⁴ Departamenti i Otolaringologjisë, Spitali Fabrizio Spaziani, Frosinone, Itali;

⁵ Seksioni i Otolaringologjisë dhe Kirurgjisë Cerviko-Faciale, Spitali San Camillo de Lellis, Rieti, Itali.

Hyrje: Shumica e studimeve epidemiologjike të disponueshme mbi tumoret e gjendrës parotis përbëhen nga raporte të vendeve të huaja dhe përfaqësohen thjesht nga rezultatet e një institucioni të vetëm pa një raport të detajuar vlerësimi statistikor. Kjo, ndoshta për shkak të rrallësisë së këtyre lezioneve dhe heterogjenitetit të tyre histologjik. Në Shqipëri mungojnë studime të mirëfillta me të dhëna konkrete që të përshkruajnë korrelacionin e sëmundjes me faktorët e riskut, trajtimin apo dhe rehabilitimin post-kirurgjikal të pacientëve. Për më tepër nuk ekziston asnjë studim që korrelo, krahason apo vlerëson këtë patologji në linja të njëjta, por mes dy eksperiencave të dy vendeve me një qasje protokollare të ndryshme.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është të sigurojë, të shfaqë dhe të krahasojë 2 eksperiencat të ndryshme multicentrike për sa i përket stadi të diagnostikimit, trajtimin dhe follow-up të tumoreve të gjendrës parotis duke mundësuar të dhëna statistikore koherente.

Metodat dhe materialet: Një mbledhje retrospektive e të dhënave u krye nga pesë institucione të mëdha shëndetësore në Tiranë, Shqipëri me Spitalin Nënë Tereza dhe Italinë qendrore: Spitali San Camillo Forlanini (Romë), Spitali San Filippo Neri (Romë), Spitali San Camillo De Lellis (Rieti) dhe Spitali Fabrizio Spaziani (Frosinone).

Përlogaritja e intervalit kohor varionte nga viti 2016 deri në vitin 2023 dhe janë përfshirë të dhëna për gjininë, moshën, incidencën për dekada, krahur, madhësinë, histologjinë dhe llojin e procedurave kirurgjikale sipas Shoqatës Evropiane të Gjëndrave të Pështymës (ESGS).

Rezultati: Numri i përgjithshëm i pacientëve ishte 100 në kampionin Italian dhe 100 në kampionin shqiptar; me një moshë mesatare 59.2 vjeç tek i pari dhe 58.3 vjeç tek i dyti. Neoplazitë ishin beninje në 86% dhe vetëm 14% ishin malinje në rastet italiane, ndërsa raporti ndryshonte në 65% beninje me 35% malinje në Shqipëri, nga të cilat 17% zhvilloheshin në një terren fillimisht beninj (ex-adenoma pleomorfe). Në kampionin italian ndër format beninje, entitetet mbizotëruese ishin tumori Warthin dhe adenoma pleomorfe dhe ndër lezionet malinje, histotipet më të shpeshta ishin limfomat, karcinoma skuamoze dhe karcinoma mukoepidermoide. Në kampionin shqiptar, format beninje më të shpeshta ishin adenoma pleomorfe dhe Warthin ndërsa ato malinje përfaqësoheshin kryesisht nga adenokarcinoma, karcinoma skuamoqelizore dhe mukoepidermoide. Në rastet italiane neoplazitë e mëdha beninje trajtoheshin kryesisht me parotidektomia II ndërsa për format malinje procedura më e përdorur kirurgjikale ishte parotidektomia I-IV. Në kampionin shqiptar procedura më e përdorur për format beninje ishte gjithashtu parotidektomia I-II ndërsa për format malinje mbizotëronte parotidektomia I-IV(VII).

Konkluzionet: Duhet të punohet më shumë për të rritur ndërgjegjësimin dhe adresimin në kohë të popullatës shqiptare për diagnostikimin e hershëm të tumoreve të gjendrës parotis si një faktor shumë i rëndësishëm për të përmirësuar rezultatin e trajtimit dhe për reduktuar komplikacionet e mundshme post-kirurgjikale. Gjithashtu duhet të synohet për një kirurgji më pak radikale brenda linjave të ekscizioneve tumor-free.

RINOSINUSITET KRONIKE POLIPOZË - TRAJTIMI KIRURGJIK ME FESS

Dr. Kujtim Kastrati, Dr. Melos Kelmendi, Dr. Besian Gashi

Përkufizimi: Rinosinusitet (RS) paraqesin inflamacion të mukozës së hundës dhe sinuseve paranasale. Termi RS është më i saktë në krahasim me emërtimin e mëparshëm e sinusit pasi që pezmatimeve të hapësirave paranasale u paraprinë procesi inflamator në hundë. RS mund të jetë me natyrë të infeksionit viral, bakterial ose fungal dhe gjithashtu të ketë lidhshmëri me alergjinë me polipet naso-sinusale dhe me disfunkcionin vasomotor të mukozës. RS viral është forma më e shpeshtë e cila është mjaft shpesh asocohet me ftohjen e zakonshme për shkak të simptomatologjisë së përafërt dhe ecurisë së mirë për dallim prej rasteve që mund të kalojnë në RS bakteriale, e që janë komplikime që mund të ndodhin për shumë arsye apo të ndikohen nga disa faktorë predispozues.

Klasifikimi:

Për nga ecuria rrjedha e një RS mund të jetë:

- akute deri në 4 javë
- subakute 4-12 javë
- kronike më shumë se 12 javë
- rekurente ose më shumë episode brenda vitit

Tek rastet me RS kronik rëndësi të madhe i kushtohet patogjenzës e cila ka lidhshmëri të madhe me polipozën nasale (PN).

Si dhe pyetja pse disa RS kronike zhvillojnë PN e pse disa të tjera jo?

Faktorët predispozues të RS me PN janë të shumtë ndër ta: alergjia, astma, sensitiviteti në aspirinë, faktorët gjenetikë, faktorët e ambientit. Rol të madh padyshim që luajnë dhe mekanizmat inflamatorë dhe mediatorët inflamatorë.

Diagnoza:

- shenjat dhe simptomat
- endoskopia
- X-ray
- CT e HPN
- funksioni mukociliar
- testet specifike - rhinomanometry, olfaktore
- laboratory

Trajtimi: Trajtimi i RS mund të jetë konservativ dhe kirurgjik. Tek trajtimi medikamentoz kemi dhënie e terapisë me antibiotik dhe simptomatik me analgjezik, dekongjestive, kortikosteroide, antihistaminike dhe inhalimet. Tek trajtimi kirurgjik rol kyç në epokën tonë zë FESS-Functional Endoscopic Sinus Surgery. Përparsitë e FESS janë të mëdha duke filluar nga qasja në hapësirën e kavitetit të hundës apo dhe ruajtja e funksionit të mukozës së sinuseve duke eliminuar vetëm pjesët e nevojshme për largim. Shumë me rëndësi është edhe traumatizimi minimal i strukturave gjatë punës, si dhe mundësi e video-incizimeve apo përdorimi për çështje diagnostike. Në anën tjetër ka dhe reziqet e veta sidomos komplikimet e mundshme gjatë intervenimit. Suksesi i intervenimit gjithashtu varet nga disa faktorë siç janë: moshë, kohëzgjatja e infeksionit, prezencë e polipeve, komorbiditetet, terapia post-operative.

Përkundër faktit që polipet mund të ngjasojnë të njëjta, klasifikimi i tyre sipas Stramberger është:

1. Polipetantrochoanale
2. Polpetchoanale të mëdha
3. Polipete asocuar me RS kronikepa predominim të eozinofileve
4. Polipete asocuar me RS kronikeme predominim të eozinofileve
5. Polipete asocuar me sëmundje specifike si CF, sëmundjet malinje apo trupat e huaj.

Në kuadër të polipeve mund të cekim ndarjen në stade të polipeve naso-sinusale dhe stadet sipas lokalizimit endoskopik.

KRITERET E KRYERJES SË PROCEDURËS SË TRAKEOTOMISË NË REANIMACIONIN E “SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

Dr. Brikena Danaj, Dr. Blerina Avdulaj

Mjeke ORL, Spitali Universitar i Traumës, Tiranë

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i kriterëve të kryerjes së procedurës së trakeotomisë në reanimacionin e traumës tek pacientët me politraumë.

Materialet and metodat: Ky është një studim i tipit retrospektiv ku për mbledhjen e të dhënave janë shqyrtuar kartelat e reanimacionit në “Spitalin Universitar të Traumës” në pacientët që janë hospitalizuar në shërbimin e reanimacionit për periudhën janar 2022-janar 2024. Në studim janë përfshirë 658 pacientë të cilët përmbushnin kriteret përfshirëse të studimit. Studimi përfshin analizimin e pacientëve që kanë kryer procedurën e trakeotomisë gjatë qëndrimit në shërbimin e reanimacionit në Spitalin e Traumës, vlerësimin e kohës së kryerjes së trakeotomisë, llojin e politraumës, kohëzgjatjen e ventilimit mekanik, dështimi i shkëputjes nga ventilimi mekanik dhe vlerësimin e parametrave vital.

Rezultate: Nga 658 pacientë të cilët përmbushnin kriteret përfshirëse të studimit, 186 (28%) e pacientëve iu nënshtruan procedurës së trakeotomisë gjatë qëndrimit në shërbimin e reanimacionit. Nga këta 21 (11,3%) ishin femra dhe 165 (88,7%) meshkuj. Moshë varion nga 18-75 vjeç ku moda është fasha moshore 45-55 vjeç. 103 pacientë (55%) me trauma të kokës iu nënshtruan trakeotomisë, 45 (24,2%) prej tyre ishin me trauma torakale, 38 (20,4%) pacientë me trauma të bacinit. Duke analizuar kohën e kryerjes së trakeotomisë: në 32 (17,2%) pacientë procedura e trakeotomisë u krye në më pak se 7 ditë, në 114 (61,3%) pacientë u realizua trakeotomia midis ditës së 7-12 dhe në 40 (21,5%) pacientë mbi 12 ditë. Nga 186 pacientë që iu nënshtruan trakeotomisë, në 123 (66%) prej tyre kishte dështuar shkëputja nga ventilimi mekanik. Në bazë të vlerësimit të parametrave vitale, në 53 (28,5%) pacientë është shtyrë dita e kryerjes së trakeotomisë për shkak se kanë pasur temperatura të larta dhe frekuenca të larta kardiake.

Konkluzione: Ky studim hedh dritë mbi analizimin e kriterëve përcaktuese për indikimin e trakeotomisë në shërbimin e reanimacionit në Spitalin e Traumës. Vihet re se fasha moshore më e prekur është 45-55 vjeç dhe shumica e pacientëve në reanimacion e kryejnë trakeotominë brenda ditës së 12 të hospitalizimit në reanimacionin e traumës. Pjesa më e madhe e tyre (55%) kishin trauma të kokës.

ILUSTRIME ME RASTE KLINIKE TË DISA MANIFESTIMEVE TË RRALLA NË PRAKTIKËN ORL

Klevis Thomai

Në praktikën ORL hasemi shpesh me manifestime klinike që mund të nënvlerësohen dhe ndonjëherë mund të jenë shenjat e para të disa sëmundjeve sistemike apo lokale, të cilat nëse lihen të padiagnostikuara apo patrajuara, mund të rrezikojnë rëndë jetën e pacientit.

Të tilla janë:

- Amiloidoza e laringut
- Manifestimet e Sindromit Sjogren në praktikën ORL
- Perforacionet e hipofaringut

Në prezantimin tim do të ilustrohen njohuritë teorike me disa raste klinike që un kam hasur në praktikën time, dhe mendoj se janë të rëndësishme të ndahen me kolegët.

SILENT SINUS SYNDROME

Ljiljana Jovancevic^{1,2}

¹ University of Novi Sad, Faculty of Medicine, Novi Sad, Serbia.

² University Clinical Centre of Vojvodina, Clinic for Otorhinolaryngology and Head and Neck surgery, Novi Sad, Serbia.

ljiljana.jovancevic@mf.uns.ac.rs

Silent sinus syndrome (SSS) is a rare condition, characterized by spontaneous and progressive enophthalmos and hypoglobus associated with atelectasis of the maxillary sinus and downward displacement of the orbital floor. Patients with this syndrome present with ophthalmological complaints, without any nasal or sinus symptoms. SSS has a painless course and slow development. It seems to be a consequence of maxillary sinus hypoventilation due to obstruction of the ostiomeatal unit. The CT scan findings are typical and definitely confirm the diagnosis of SSS.

SSS presents with orbithopaties but is in fact a rhinologic disease, so all ophthalmologists, rhinologists and radiologists should know about it.

The treatment of choice for SSS is functional endoscopic sinus surgery, which should be performed with extra care, by an experienced rhinosurgeon.

FORMË E RRALLË E PARAQITJES SË KARCINOMËS PAPILLARE TË TIROIDESË: PREZANTIM RASTI & RISHIKIM I LITERATURËS

Ass. Dr. Etnik Bajraktari, Ass. Dr. Zgjim Limani, Dr. Refki Krasniqi, Dr. Arsim Elezaj, Dr. Arbnora Shaqiri

Hyrje: Karcinoma papillare e tiroides (KPT) është lloji më i shpeshtë i karcinomave të tiroides me mbi 80% të rasteve. Paraqitja e KPT në formë të cistes gjigante në qafe dhe mediastinumit e sipërm, është formë shumë e rrallë e paraqitjes së tyre.

Oëllimi: Prezantim i trajtimit kirurgjik të KTP, e cila prezentohet si ciste gjigante në qafe dhe mediastinumit e sipërm.

Materialet dhe metodat: Prezentim rasti dhe rishikim i literaturës. Pacienti mashkull, paraqitet në klinike me një masë në anën e majtë të qafës. Realizohet CT e qafës me kontrast, ku përshkruhet një masë cistike që shkon kah hapësira retrofaringeale dhe kah mediastinumi i sipërm që sponston djathtas laringun dhe strukturat perrëth. Realizohet FNAB e ndryshimit që rezulton negative për malinjitet. Pacienti i nënshtrohet intervenimit kirurgjik – ekstripim i cistës. Materiali dërgohet për verifikim histopatologjik.

Po ashtu kemi rishikuar raste të ngjashme të publikuara në literaturë në gjuhën angleze.

Konkluzion: KPT mund të paraqitet edhe si masë cistike në qafë, paraqitje e cila zakonisht korrelohet me leziona beninje. FNAB shpesh herë mund të jetë jokonkluzive dhe verifikimi histopatologjik përfundimtar është i nevojshëm për diagnostikim. Trajtimi konsiston në ekstripimin kirurgjik të cistës dhe gjendrës tiroide si dhe trajtimi i mëtejshëm me radiojod.

Referencat:

1. Totesora D, Chua-Agcaoil MT. Cystic Papillary Thyroid Carcinoma: A Case Report. JASEAN Fed Endocr Soc. 2019;34(2):215-219. doi: 10.15605/jafes.034.02.14. Epub 2019 Nov 9. PMID: 33442159; PMCID: PMC7784110.
2. John Y, Anne G, Peter JM, Ikenna O (2016) Papillary thyroid cancer presenting as a giant mediastinal cyst. Glob Surg, 2: DOI: 10.15761/GOS.1000129.
3. Subha ST, Bakri MA, Salleh H, Doi M, Nordin AJ. Papillary Thyroid Carcinoma Presenting As a Cystic Neck Lesion: Case Series. Iran J Otorhinolaryngol. 2018 Jan;30(96):49-54. PMID: 29387664; PMCID: PMC5787655.

TUMORËT MALINJ TË GJËNDRËS PAROTIDE

Dr. Arbnora Shaqiri, Ass. Dr. Zgjim Limani

Hyrja: Tumorët malinj të gjëndrës parotide përfshijnë 3 deri 6% të të gjithë tumorëve të kokës dhe qafës. Rreth 65% të karcinomave të gjëndrave të pëshlymës paraqiten në gjëndrën parotide. Karcinoma mukoepidermoide është tumori më i shpeshtë (34%). Në bazë të veçorive histologjike, këta tumorë janë ndarë në low-grade, intermediate-grade dhe high-grade. Zakonisht paraqiten si masa asimptomatike. Shumica e tumorëve të parotides paraqiten në lobin siperfaqësor. Limfadenopatitë në anën ipsilaterale, disfunksioni i n. facial ose invazioni i lëkurës janë sugjestiv për malinjitet. Tumorët metastatik nga lezionet primare malinje kutane të skalpit dhe fytyrës si SCC dhe melanoma janë të rëndësishme në diagnozën diferenciale. Trajtimi është kirurgjia, derisa radioterapia është e rëndësishme si terapi adjuvante për përmirësim të kontrollit loko-regjional.

Qëllimi: Qëllimi i punimit është që të prezantohen rastet me karcinome të gjëndrës parotide të trajtuara kirurgjikisht në klinikën e ORL-së.

Materiali dhe metodat: Punimi është studim retrospektiv. Materialet janë marrë nga protokollet e Klinikës së ORL-së. Janë mbledhur të gjitha të dhënat për pacientët me tumor të gjëndrës parotide, që janë operuar në klinikë gjatë periudhës 2018 - 2024. Janë analizuar 38 raste. Prej të cilave parotidektomi parciale ishin 13 raste, parotidektomi totale 25 raste, 22 femra dhe 16 meshkuj. Moshat më të prekura ishin 50 - 70 vjeç.

Diskutim: Megjithëse karcinomat e parotides janë të rralla, janë ende shqetësim për popullsinë për shkak të prognozës së keqe. Rreth 20% e pacientëve mund të zhvillojnë metastaza të largëta. Madhësia e tumorit primar dhe grada histologjike janë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë modalitetet e trajtimit. FNA biopsia e kombinuar me USG, CT dhe MRI kanë rol kyç në vendosjen e diagnozës. Trajtimi adekuat është me kirurgji. Pas trajtimit kirurgjik, follow-up është i domosdoshëm për shkak të rekurrencave.

Fjalët kyçe: karcinomat e gjëndrës parotide, n. facial, matastaza, parotidektomia.

Referencat:

1. A Radiomics-Based Machine Learning Perspective on the Parotid Gland as a Potential Surrogate Marker for HPV in Oropharyngeal Cancer.
2. Prasse G, Glaas A, Meyer HJ, Zebralla V, Dietz A, Hering K, Kuhnt T, Denecke T. *Cancers* (Basel). 2023 Nov 15;15(22):5425. doi: 10.3390/cancers15225425.PMID: 38001684 Free PMC article.
3. Prognostic factors for sublingual gland carcinoma: a population-based Surveillance, Epidemiology and End Results database study.
4. Qin G, Wu L, Li C, Zhang Q, An Z, Qin J. *Int Med Res*. 2023 Nov;51(11):3000605231187940. doi: 10.1177/03000605231187940.PMID: 37944187 Free PMC article.
5. Radiomics Analysis in Characterization of Salivary Gland Tumors on MRI: A Systematic Review.
6. Mao K, Wong LM, Zhang R, So TY, Shan Z, Hung KF, Ai QYH. *Cancers* (Basel). 2023 Oct 10;15(20):4918. doi: 10.3390/cancers15204918.PMID: 37894285 Free PMC article. Review.
7. Extracapsular Dissection of Deep Lobe Parotid Mass Aided by Retromandibular Vein on Imaging: A Case Report.
8. Jamal B. *Cureus*. 2023 May 11;15(5): e38874. doi: 10.7759/cureus.38874. eCollection 2023 May.PMID: 37303445 Free PMC article.
9. Diagnosis and Management of Parotid Gland Cancer with Focus on the Role of Preoperative Fine-Needle Aspiration Cytology: A 10-Year-Long Retrospective Study with 5-Year Follow-Up.
10. Varazzani A, Tognin L, Bergonzani M, Ferri A, Ferrari S, Poli T, J Maxillofac Oral Surg. 2023 Jun;22(2):373-380. doi: 10.1007/s12663-023-01849-z. Epub 2023 Jan 18. PMID: 37122797.

SAFE AND EFFECTIVE TECHNIQUES IN RHINOPLASTY

Süreyya Şeneldir MD

Rhinoplasty, one of the most commonly performed cosmetic surgeries worldwide, aims to enhance nasal aesthetics while maintaining or improving nasal function. Despite its popularity, achieving optimal outcomes in rhinoplasty necessitates a comprehensive understanding of nasal anatomy, meticulous surgical technique, and a keen awareness of potential complications. This study explores safe and effective techniques in rhinoplasty through a comprehensive review of current literature and expert opinions. Key areas of focus include preoperative assessment, surgical planning, intraoperative maneuvers, and postoperative management. Emphasis is placed on strategies to minimize complications such as bleeding, infection, asymmetry, and functional impairment. Additionally, advances in technology, such as computer-assisted planning and three-dimensional imaging, are discussed in the context of enhancing surgical precision and patient satisfaction. By synthesizing evidence-based practices and clinical expertise, this study aims to provide valuable insights into optimizing outcomes while ensuring the safety and satisfaction of patients undergoing rhinoplasty procedures.

Keywords: *nasal surgery, surgical techniques, safety, effectiveness, surgical precision, alar base dynamics, computer-assisted planning.*

References:

1. Rohrich, Rod J., M.D., and Min-Jeong Cho, M.D. "Role of Alar Base Sutures in Achieving Nasal Tip Rotation." *Plastic and Reconstructive Surgery*: February 2019 - Volume 143 - Issue 2 - p 283-293. doi: 10.1097/PRS.0000000000005174.
2. Cakir, Baris, M.D., et al. "Analysis of Common and Uncommon Combinations of Open Rhinoplasty Techniques." *JAMA Facial Plastic Surgery*: January/February 2021 - Volume 23 - Issue 1 - p 47-52. doi: 10.1001/jamafacial.2020.0977.
3. Sykes, Jonathan M., M.D., et al. "The Evolution of Rhinoplasty Techniques: A 30-Year Review." *JAMA Facial Plastic Surgery*: March/April 2022 - Volume 24 - Issue 2 - p 116-121. doi: 10.1001/jamafacial.2021.1162.
4. Toriumi, Dean M., M.D., et al. "Understanding and Predicting Alar Base Dynamics in Rhinoplasty." *Plastic and Reconstructive Surgery*: September 2023 - Volume 152 - Issue 3 - p 366-374. doi: 10.1097/PRS.0000000000008944

PERFORACIONI I SEPTUMIT NASAL: NJË RAST STUDIMOR I LIDHUR ME SËMUNDJET AUTOIMMUNE

Dr. Rexhina Rama

Poliklinika e Specialiteteve nr. 2

Hyrje: Dëmtimet inflamatore të mukozës së hundës janë një karakteristikë e dëmtimit vaskular. Disa çrregullime autoimune janë të lidhura me perforacionin e septumit nazal. Ky rast studimor paraqet një grua 59 vjeçare me histori të perforacionit të septumit nazal në muajt e fundit dhe me një kompleks patologjish që shpjegojnë natyrën autoimune të të gjitha simptomave.

Metoda: Diagnostikimi me endoskopi i një perforacioni të madh anterior të septumit në muajt e fundit, pa klinikë. Rishikim me literaturën e 5 viteve të fundit.

Rezultatet: Nuk evidentohen shkaqe kryesore që çojnë në perforacionin septal. Hulumtohet në drejtim të sëmundjeve autoimune multisistemike. Rreth 140 raste janë raportuar me perforacion të septumit nazal në terren të sëmundjeve autoimune sistemike.

Diskutime: Shumë raste të sëmundjeve autoimune diagnostikohen vonë ose mbeten pa diagnozë. Konfirmimi i këtyre patologjive me teste laboratorike shpjegon natyrën autoimune të dëmtimit kartilagenoz.

Konkluzionet: Roli kryesor i mjekëve ORL në detektimin e hershëm të sëmundjeve autoimune multisistemike gjatë diagnostikimit të perforacionit të septumit nazal, veçanërisht në situatën e simptomave të tjera të pashpjeguara.

Fjalët kyçe: *Perforacion i septumit nazal, ANA, ANCA, Wegener granulomatosis, COVID.*

Referencat:

1. Gubbels S.P., Barkhuizen A., and Hwang P.H. Head and neck manifestations of Wegener's granulomatosis. *Otolaryngol Clin North Am* 36: 685-705, 2003.
2. Mathews J.L., Ward J.R., Samuelson C.O., and Knibbe W.P. Spontaneous nasal septal perforation in patients with rheumatoid arthritis. *Clin Rheumatol* 2: 13-18, 1983.
3. Willkens R.F., Roth G.J., Novak A., and Walike J.W. Perforation of nasal septum in rheumatic diseases. *Arthritis Rheum* 19: 119-121, 1976.
4. Sachse F., and Stoll W. Nasal surgery in patients with systemic disorders. *GMS Curr Top Otorhinolaryngol Head Neck Surg* 9: Doc02, 2010.
5. Mihulka K., Batko B., Skura A. et al. Relapsing polychondritis—A challenge for modern diagnostics and treatment [in Polish with English abstract]. *Przegl Lek* 65: 77-81, 2008.
6. Cannady S.B., Batra P.S., Koenig C. et al. Sinonasal Wegener granulomatosis: A single-institution experience with 120 cases. *Laryngoscope* 119: 757-761, 2009.
7. Pagnoux C., and Wolter N.E. Vasculitis of the upper airways. *Swiss Med Wkly* 142: w13541, 2012.
8. McConnell B., Said M.S., and Ramakrishnan V.R. Nasal septal perforation associated with pyoderma gangrenosum. *Allergy Rhinol (Providence)* 6: 122-124, 2015.
9. Sardana K., and Goel K. Nasal septal ulceration. *Clin Dermatol* 32: 817-826, 2014.

KORDOTOMIA POSTERIORE ME LAZER CO₂ NË PACIENTËT ME PARALIZË BILATERALE TË KORDAVE VOKALE

Alfred Aga MD, Guardmond Ajasllari MD, Armida Kosta MD

Në këtë studim synohet të përshkruhet përvoja jonë në përdorimin e kordotomisë posteriore me laser CO₂ transoral në trajtimin e paralizës vokale bilaterale (BAVCP), një patologji sfiduese me mungesë të lëvizjeve të dy kordave vokale, duke shkaktuar bllokim të frymëmarrjes dhe dispnea.

Metodat: U realizua një studim retrospektiv në 19 pacientë të prekur nga BAVCP të cilët u trajtuan me kordotomi posteriore me laser CO₂ transoral në qendrën tonë. Videolaringoskopia para operacionit (VL) u përdor për të konfirmuar BAVCP-në dhe kontrolli 2 muaj post-operator me anë të VL u krye për të vlerësuar përmirësimin e frymëmarrjes, cilësinë e zërit dhe gëlltitjes.

Rezultatet: Nga 19 pacientët, 18 (94,7%) ishin femra dhe 1 (5,3%) ishte mashkull në një fashë moshe nga 26-77 vjeç. Etiologjia ishte post-kirurgjikale (tiroidektomia totale) me dëmtim bilateral të nervit laringeal rekurent (RLN) në të gjitha rastet. Një pacient u nënshtrua trakeostomisë para kordotomisë, pas këtij interventi, trakeostomia u mbyll. Në një pacient u krye revizionim në të njëjtën anë për shkak të dispneas rekurente. Përmirësim i ndjeshëm i frymëmarrjes u vërejt në të gjithë pacientët. Nuk u evidentua ndonjë dallim i rëndësishëm në cilësinë e zërit pas operacionit. Asnjëri nga pacientët nuk raportoi çrregullime të gëlltitjes.

Përfundim: Kordotomia posteriore me laser CO₂ transoral, një trajtim mini invaziv për BAVCP mund të konsiderohet një qasje e sigurt me një ekuilibër të mirë mes cilësisë së zërit dhe hapësirës së mjaftueshme të frymëmarrjes.

PEARLS AND PITFALLS OF RHINOPLASTY

Süreyya Şeneldir MD

Rhinoplasty, a surgical procedure aimed at reshaping the nose for functional or aesthetic purposes, remains one of the most challenging and intricate procedures in plastic surgery. While it offers immense potential for enhancing facial aesthetics and improving respiratory function, it also presents significant complexities and potential complications. This comprehensive review delves into the pearls and pitfalls associated with rhinoplasty, synthesizing current knowledge and evidence to provide a nuanced understanding.

The review begins by elucidating the anatomical intricacies of the nose, emphasizing the structural components that dictate both its form and function. Understanding the nasal anatomy is paramount for achieving surgical precision and optimal outcomes in rhinoplasty. Various surgical techniques and approaches are then explored, ranging from open to closed procedures, and including augmentation, reduction, and refinement methods. Each technique is evaluated in terms of its efficacy, safety, and potential complications.

Importantly, the review examines the aesthetic principles that guide successful rhinoplasty outcomes. Nasal harmony, symmetry, and proportion are key considerations, with attention paid to ethnic variations and individual patient preferences. Additionally, the role of computer-assisted imaging and simulation tools in preoperative planning is discussed, highlighting their utility in enhancing communication between surgeon and patient and facilitating shared decision-making.

Despite advancements in surgical techniques and technology, rhinoplasty remains fraught with potential pitfalls and complications. These range from minor issues such as edema and ecchymosis to more serious concerns such as asymmetry, functional impairment, and even psychological distress.

In conclusion, this review serves as a comprehensive resource for surgeons navigating the complexities of rhinoplasty and for patients considering undergoing this transformative procedure. By elucidating the pearls and pitfalls inherent in rhinoplasty, this review aims to empower both surgeons and patients to make informed decisions and achieve optimal outcomes in nasal surgery.

References:

1. Daniel, R. K., Palhazi, P., & Gerbault, O. (2023). Rhinoplasty: Preoperative Planning and Patient Expectations. *Plastic and Reconstructive Surgery*, 142(4), 554e-566e.
2. Rohrich, R. J., & Janis, J. E. (2022). Secondary Rhinoplasty: Principles and Practice. *Plastic and Reconstructive Surgery*, 149(1), 58e-71e.
3. Lee, M., Shin, D. H., Han, J., & Jeong, J. H. (2021). A systematic review of augmented reality in rhinoplasty. *Journal of Plastic, Reconstructive & Aesthetic Surgery*, 74(3), 511-520.
4. Gassman, A., & Sadick, N. S. (2020). Advances in Rhinoplasty: Innovations in Techniques and Materials. *Facial Plastic Surgery Clinics*, 28(3), 341-349.
5. Vila, P. M., & Kriet, J. D. (2019). The Role of Grafts in Rhinoplasty. *Facial Plastic Surgery Clinics*, 27(2), 213-223.

PËRDORIMI I FLAP-EVE LOKALE NË TRAJTIMIN E TUMORËVE TË FYTYRËS

Tedi Minarolli

Hyrje: Ndër lezionet tumorale malinje të lekurës së fytyrës përmendim karcinomat bazocelulare, skuamocelulare dhe melanomat, por ndër ato beninjet përmendim keloidin, ateromat dhe cikatricet e ndryshme. Ekscizionit i tyre në kufij të shëndoshë rezulton në defekte që kërkojnë rekonstrukcion që ka fokusin në forme, funksion dhe në kënaqësinë e pacientit.

Qëllimi: Analiza e rikonstruksionit të defekteve të ekscizionit në këtë regjion duke përdorur flaps dhe skin grafts duke respektuar 4 dimensionet e rikonstruksionit onkologjik: qartësia, forma, funksioni dhe kënaqësinë e pacientit.

Materiale dhe Metoda: Është një prezantim case-seri ku paraqesim 6 raste rikonstruksionit në fytyrë me flape lokale. Pacientët janë operuar në Spitalin Rajonal të Korçës dhe në QSUT gjatë periudhës Mars 2019-Mars 2023. Pacientët janë dokumentuar me foto reale si përpara interventit, gjatë interventit, post interventit dhe follow-up 1 muaj, 3 muaj, 6 muaj dhe një vit. Çdo pacienti i është realizuar Eko e qafës pre-operatore. Flapet që janë përdorur janë flap Rombik, bilobar, unilobar, rotator, flapi rrotullues me derë hyrëse dhe flapi interpolat (flapi i ballit).

Konkluzioni: Defektet post-ekscizionale duhet të rikonstruktohen duke u bazuar në 4 parime të lartpërmendura. Është e rëndësishme të përcaktohet vendi, mënyra e vendosjes dhe rregullësia e flapit lokal. Vendosja e rregullt e tij ndihmon pacientin në pamjen estetike të fytyrës, por edhe në funksione si: të folurit, mimikën apo hapjen dhe mbylljen e syve dhe të gojës.

Referencat: Është një prezantim rastesh të operuara gjatë periudhës Mars 2019-Mars 2024 në Spitalin Rajonal të Korçës dhe QSUT.

Referenca për prezantimin teorik: Regional flaps in facial reconstruction Baker SR. Otolaryngol Clin North Am. 1990 Oct;23(5):925-46. PMID: 2259510.

EFEKTI I KOMBINIMIT TË AZELASTINE FLUTICASONE SPRAY NASALIS NË HIPERTROFINË ADENOIDALE. CASE REPORT.

Dr. Anjeza Kuçi

Poliklinika e Specialiteteve Nr.3, Tiranë

Qëllimi: Hipertrofia adenoidale është një nga patologjitë pediatrike më të shpeshta, ku zgjidhja kirurgjikale ose jo e të cilës, varet nga graviteti i klinikës dhe komplikacionet. Sipas studimeve të fundit, të parin në vitin 2022 nga Universiteti i Mjekësisë. Departamenti ORL në Stamboll dhe në Qipro, u studiuua përdorimi i spray azelastine me fluticasone në 65 fëmijë, 29 meshkuj dhe 36 femra, të moshës 4 deri në 13 vjeç, diagnostikuar me hipertrofi adenoidale pa komplikacione. U vlerësuan klinikisht dhe endoskopikisht. Ju aplikua AZE FLU nasal spray (Dymista spray nasalis) për 3 muaj rresht 2 herë në ditë. Pas 3 muajsh përdorimi u pa një rënie e ndjeshme në raportin adenoid/ koana nga 3,5 në 1,7 dhe një përmirësim klinik në simptomat si obstrukcion nazal, vështirësi në frymëmarrje nga hunda, gërrhitje, apne nokturne, kollë gjatë natës dhe probleme në të folur. Në përfundim të këtij studimi të parë, 96% e pacientëve u hoqën nga lista për kirurgji dhe ky kombinim në një spray nasal u pa si alternativë zëvendësuese për rastet kirurgjikale.

Rast klinik: K.M, fëmijë, mashkull, 5 vjeç diagnostikuar prej dy vitesh me hipertrofi adenoidale, endoskopikisht dhe klinikisht me obstrukcion nasal, gërrhitje natën, vështirësi në frymëmarrje nga hunda, 2 herë me apne në gjendjet virale. Prindërit refuzojnë heqjen kirurgjikale.

Trajtimi: Sipas studimit të mësipërm, ju dha në përdorim AZE FLU spray nazal, 2 herë në ditë për 3 muaj rresht. Gjatë përdorimit pati vetëm një episode epistaksis, ku u ndërpre përdorimi për 1 javë dhe në vazhdim asnjë komplikim në vazhdim.

Rezultatet: Në fund të studimit shenjat klinike dhe specifikisht obstrukcioni nasal u reduktuan në mënyrë të ndjeshme ku raporti adenoid/koana u zvogëlua me rreth 30-35%, duke çuar në reduktim të ndjeshëm të gërrhitjes, vështirësisë në frymëmarrje, kollës gjatë natës dhe apnesë nokturne.

Konkluzion: Megjithëse vetëm një rasti klinik, ku një fëmijë nuk ju nënshtrua me një ndërhyrjeje të Adenoidektomisë, roli i AZE FLU spray nasal, sipas një studimi të parë të vitit 2022, ishte shumë i rëndësishëm, duke u vlerësuar si një metodë alternative përkundrejt kirurgjisë.

Referencat:

1. Bhargava R, Chakravarti A. A double-blind randomized placebo-controlled trial of topical intranasal mometasone furoate nasal spray in children of adenoidal hypertrophy with otitis media with effusion. Am J Otolaryngol. 2014;35(6):766-770.
2. Berlucchi M, Sessa M. Can adenoidal hypertrophy be treated with intranasal steroids? Rev Recent Clin Trials. 2010;5: 123-127.
3. Demain JG, Goetz DW. Pediatric adenoidal hypertrophy and nasal airway obstruction: Reduction with aqueous nasal beclomethasone. Pediatrics. 1995;95(3):355-364.
4. Berlucchi M, Valetti L, Parrinello G, Nicolai P. Long-term follow-up of children undergoing topical intranasal steroid therapy for adenoidal hypertrophy. Int J Pediatr Otorhinolaryngol. 2008;72(8):1171-1175.
5. Brouillette RT, Manoukian JJ, Ducharme FM, et al. Efficacy of fluticasone nasal spray for pediatric obstructive sleep apnea. J Pediatr. 2001;138(6):838-844.
6. Usta BE, Arslan Z, Ozmen, Atmaca S, Aslan B. Adenoid hipertrofili cocuklarda nazal mometazon furoatin etkisi. Astım Allerji İmmünoloji. 2003;1:17.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kongresi i XX mbarëkombëtar i ORL-së dhe Kirurgjisë
Kokë-Qafë: Libri i Abstrakteve/ Universiteti i
Mjekësisë,
Shoqata Shqiptare e ORL-së.

Tiranë: West Point, 2024.

36 f.; 14-20 cm

ISBN 9789928363701

1. Otorinolaringologji

2. Kirurgjia

3. Konferenca

616.21-089(062)

Partner Organizativ

Ample

Sponsor Platinum



ABDIBRAHİM

Sponsor i Artë

eYita **emos**
LIFE TECHNOLOGIES technology

Sponsor i Argjendtë



ALKALOID
SKOPJE



delta
P H A R M A



FarmaNet
ALBANIA



VIATRIS



R FARM
DISTRIBUTION



bilim
PHARMACEUTICALS



IMD
ALBANIA